

RAPORT MONITORIMI

# ANALIZA E SHPENZIMEVE FINANCIARE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE NË SHQIPËRI

VITI AKADEMIK 2021 - 2022



QENDRESA  
QYTETARE

FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG





**Realizuan:**

Autor: Rigels Xhemollari

**Ekspertë monitorimi:**

Besjana Hysa

Ines Mulellari

**Ekipi i monitoruesve:**

Gevio Tabaku

Orjana Cekrezi

*Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert. Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.*

**2022**

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

- 1. ÇFARË PËRMBAN RAPORTI I MONITORIMIT?**
- 2. SI ADMINISTROHEN FINANCAT NË IAL-TË PUBLIKE?**
- 3. METODOLOGJIA E MONITORIMIT**
- 4. GJETJET KRYESORE**
- 5. ANALIZË E SHPENZIMEVE NË 6 UNIVERSITETE PUBLIKE**
  - a. Kategoria “ Shpenzime Personeli”**
  - b. Kategoria “ Investime”**
  - c. Kategoria “Blerje mallrash”**
  - d. Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”**
  - e. Kategoria “Bursa dhe transferta për subvencione të tjera”**
  - f. Pasqyrë e plotë e shpenzimeve të 6 universiteteve publike në periudhën 1 Shtator 2021 31 Gusht 2022**
- 6. PORTALI U-TRANSPARENCA.AL**
- 7. UNIVERSITETET DHE E DREJTA E INFORMIMIT**
- 8. REKOMANDIME**
- 9. SKEDAT E TRANSPARENCES**

# 1. KUJT I SHËRBEN KY RAPORT MONITORIMI?

Qëndresa Qytetare është një organizatë e fokusuar tek fuqizimi i rolit të qytetarit në shoqëri dhe synon përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet angazhimit dhe aktivizmit qytetar. Nisur nga mungesa e shërbimeve ndaj studentëve në universitetet publike, tarifat e larta që aplikohen në to e në tërësi nga ankesat e artikuluar gjatë protestës së studentëve në muajin dhjetor 2018, por edhe protestës së pedagogëve për pagat në qershor - shtator 2022, vendosëm të kryejmë këtë monitorim me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, i cili realizohet për të pestin vit akademik radhazi.

Vlera e këtij monitorimi i cili u realizua edhe vitin e shkuar konsistoi në përdorimin e të dhënave nga të gjithë aktorët universitarë, qeveria dhe studentët për të ndërmarrë masat dhe politikat për përmirësimin e situatës së transparencës dhe mirëmenaxhimit të parave.

Në kuadër të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ndryshimeve që institucionet e arsimit të lartë pësuan sa i takon menaxhimit financiar dhe administrimit, **Qëndresa Qytetare monitoroi gjashtë universitete publike** me fokus investimet dhe nivelin e transparencës së tyre në raport me publikun dhe studentët për **periudhën 1 shtator 2021 – 31 gusht 2022**.

Ky monitorim shërben për të hedhur dritë mbi mënyrën se si janë shpenzuar të ardhurat që grumbullohen nga tarifat e studentëve, të ardhurat që gjeneron vetë universiteti dhe të ardhurat që vijnë nga buxheti i shtetit duke u munduar kështu t'i japë përgjigje pyetjes nëse reflektohen nevojat reale të studentëve, a përkthehen në shërbime dhe shkencë apo kemi të bëjmë më një administrim jo efektiv të buxhetit vjetor të universiteteve?

Gjithashtu kjo nismë adreson një problematikë për të cilën qeveria, si rezultat i presionit të lartë të studentëve, në "Paktin për Universitetin", për shkak të keq menaxhimit të parave, ndërmori masa duke zëvendësuar Anëtarët e Bordeve të Administrimit me figura publike si reflektim për më shumë efikasitet në menaxhimin e parave nga Anëtarët e Bordeve përfaqësues të MASR dhe më

pas për të përzgjedhur përfaqësues të studentëve tek një prej anëtarëve të bordit, zgjedhje të cilat lanë për të dëshiruar dhe nuk dhanë efektin e pritur.

Qëndresa Qytetare nëpërmjet këtij monitorimi synon të nxisë gjithashtu llogaridhënien publike të universiteteve ndaj studentëve dhe të stimulojë një nivel më të lartë transparence, nisur edhe nga fakti që tashmë është krijuar portali [u-transparenca.al](http://u-transparenca.al), një database që synonte të përmbante çdo informacion në lidhje me shpenzimet e universiteteve, por ende nuk ka dhënë rezultatet e pritura.

## 2. SI ADMINISTROHEN PARATË E UNIVERSITETEVE?

Bazuar në ligjin 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, menaxhimi financiar i universiteteve publike është i ndarë nga menaxhimi akademik. Autoritetet kryesore përgjegjëse për menaxhimin financiar janë Bordi i Administrimit, Administrator i Universitetit dhe Administratorët e Fakulteteve.

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme.

3 Anëtarë, përfaqësues të institucionit publik të arsimit të lartë, përzgjidhen nga Senati Akademik i institucionit përkatës, 4 Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin do të jenë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike dhe emërohen nga ministri përgjegjës për arsimin.

Përbërja e Bordit të Administrimit përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit publik të arsimit të lartë, të miratuar nga Bordi i Administrimit. Një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët i paraqesin ministrit tri kandidatura.

Ministri përgjegjës për arsimin emëron një prej kandidaturave të paraqitura nga studentët. Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kriteret si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Ministri përgjegjës për arsimin emëron anëtarët e bordit për secilin institucion të arsimit të lartë.

Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative. Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret miratohet nga Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit. Administratori i universitetit rekruton bazuar në procedurat e administratës publike administratorët e fakulteteve.

Në institucionet jopublike të arsimit të lartë administratori emërohet dhe shkarkohet sipas përcaktimeve në statutin e institucionit. Administratori i institucionit publik të arsimit të lartë shkarkohet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.

### 3. METODOLOGJIA

Ekipi i monitoruesve të Qëndresës hulumtoi dhe gërshetoi një sërë burimesh të informacionit për të arritur në rezultatet e studimit. Monitorimi u bazua në analizën ligjore të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë sa i përket organeve të administrimit financiar në universitete dhe shqyrtimit të të dhënave të përftuara nga **transaksionet e Thesarit**.

Gjetjet e analizuarra të transaksioneve të Thesarit u pasuruan me të dhënat e përftuara nga shfletimi i **buletinit të prokurimeve publike**, ku duken qartazi kontratat dhe objektet e marrëveshjeve që titullarët e universiteteve publike lidhin me operatorë të tretë për shërbime dhe produkte në plotësim të nevojave të universitetit.

Njëkohësisht, plot **6 kërkesa për informacion** drejtuar universiteteve të përzgjedhura u dërguan në lidhje me buxhetin, investimet dhe destinacionin e parave të mbledhura nga tarifat e studentëve, ku u administruan një sasi e madhe dokumantash financiare që përmbanin kontrata, fatura, oferta dhe çmime të blerjeve të realizuara nga 6 universitetet e përzgjedhura.

Megjithëse universitetet nuk iu përgjigjen kërkesave në afat, pas ankesave dhe vënies në lëvizje të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u bë e mundur marrja e informacioni të kërkuar.

**Në shqyrtim janë marrë të dhënat e 6 universiteteve publike, konkretisht:**



**Universiteti i Tiranës (U.T)**  
**Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan (U.E),**  
**Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (U.K),**  
**Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD),**  
**Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër (U.SH),**  
**Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)**



## 4. GJETJET KRYESORE

- UPT vijon të mbetet Universiteti me më shumë shpenzime të administratës, ku në 1 vit kalendarik përveç pagave bazë ka shpenzuar 378 281 euro për **shpërblime**, 124 000 euro për **dieta**, 21 156 euro për **telefon/internet**.
- Gjashtë universitetet publike shpenzuan 1 366 843 euro për **orendi zyre**, ku vetëm Universiteti i Tiranës bleu 350 000 euro **grila** për dritaret e universitetit dhe nuk shpenzoi asnjë lek për zërin e kërkimit shkencor.
- Krahasuar me vitin e kaluar akademik, **zëri i sigurimit të godinave është rritur** me 153 687 euro, ndërsa ai për **orendi zyre** me 410 418 euro. Ndërkohë kemi një rënie të lehtë me 7540 euro të zërit për karburant makinash dhe një **ritje pozitive** të zërit të librave me 57 356 euro në raport me vitin e kaluar.
- Universiteti i Tiranës **për të tretin vit rresht** shpenzon 0 lek për zërin e kërkimit shkencor. Ndërkohë 4 nga 6 universitete kanë shpenzuar në total 16 316 euro për kërkim shkencor, nga 4.2 milion euro që ishte në total zëri i investimeve.
- Universiteti i Shkodrës ka shpenzuar **64 100 euro për karburant**, ndërsa Universiteti Politeknik i Tiranës, nga universiteti me koston më të lartë të karburantit vitin e shkuar, gjatë vitit 2021 – 2022 është i vetmi që nuk shpenzoi për karburant.
- Në total 6 universitete shpenzuan në total për një vit akademik **2 042 087 euro për rojet e godinave të tyre. Universiteti i Tiranës** ka shpenzuar edhe 58 000 euro për sigurimin e ndërtesës në një kompani siguracioni.
- **UT ka blerë 84 000 euro letra A4 dhe rreth 100 000 euro bojra printeri**, ndërsa UPT ka shpenzuar 61 000 euro për bojra printeri dhe 44 000 euro për letër A4. Universitet “Aleksandër Moisiu” Durrës ka shpenzuar 39 000 euro për printime, ndërkohë që ky universitet zotëron printera dhe ky shërbim mund të merrej prej tyre pa një kosto kaq të lartë.
- 6 universitetet e marra në monitorim nuk iu përgjigjën në afat kërkësive për informacion të adresuar nga Qëndresa Qytetare. Pas ankimit pranë Komisioneri për të Drejtën e Informimit, vetëm Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan ka vënë në dispozicion informacion.



## 5. ANALIZË E SHPENZIMEVE NË 6 UNIVERSITETE PUBLIKE

Monitoruesit dhe ekspertët e Qëndresës Qytetare kanë kaluar në sitë dhe kanë përpunuar në mënyrë të thjeshtëzuar të gjitha transaksionet që kanë kryer gjashtë universitetet publike duke përfshirë të gjitha kategoritë e shpenzimeve gjatë periudhës **1 shtator 2021 – 31 gusht 2022, përkatësisht një vit të plotë kalendarik, përfshirë edhe atë akademik.**

Nëpërmjet kalimeve të vlerave tek të tretët apo personeli duke marrë në konsideratë edhe përshkrimin e çdo transaksioni, është bërë i mundur edhe evidentimi i pagesave dhe transfertave të dyshimta apo të pa justifikuara.

Siç kuptohet nga tabela, shpenzimet e Universiteteve sipas zërave të kategorive shkojnë pak a shumë në proporcion të rregullt me shpenzimet totale të secilit prej tyre. Në pesë nga gjashtë universitet e marrë në monitorim, pjesën thelbësore të shpenzimeve e zënë shpenzimet për personelin, të kategorizuara në kategorinë II. Ndryshim bën vetëm Universiteti i Tiranës i cili shpenzimet më të mëdha i ka në kategorinë III, Investime, pasuar nga kategoria V Sigurimi Shërbimeve, kjo ndikuar dhe nga rikonstruksioni i godinës së Fakultetit Ekonomik, por edhe nga kostoja e lartë e pagesës për sigurinë e godinave.

**Gjatë periudhës 1 shtator 2021 – 31 gusht 2022 këto 6 Universitete kanë shpenzuar në total:**

	Kategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
II	Shpenzime personeli	305,949,141	80,816,120	383,693,367	243,791,434	533,194,298	744,179,107
III	Investime	9,470,023	344,988,799	26,381,369	40,998,231	15,773,185	51,448,811
IV	Blerje mallrash	46,103,504	45,631,016	49,485,460	20,277,847	43,426,189	48,143,324
V	Sigurimi i shërbimeve	50,028,596	169,916,554	76,579,050	26,921,256	32,427,968	67,547,415
VI	Transferta dhe Subvencione	2,070,321	34,075,358	3,246,331	2,468,252	11,377,381	13,656,192
VII	Të tjera	50,794,300	418,346	105,918,010	44,212,134	62,154,500	101,136,830
	<b>Totali</b>	<b>464,415,885</b>	<b>675,846,193</b>	<b>645,303,587</b>	<b>378,669,154</b>	<b>698,353,521</b>	<b>1,026,111,679</b>

## a. Kategoria “Shpenzime Personeli”

Kategoria e shpenzimeve të personelit është ndër kategoritë që zënë peshën kryesore të shpenzimeve të universiteteve. Universiteti Politeknik i Tiranës është universiteti që ka bërë dhe shpenzimet më të larta në kategorinë **paga** në total me vlerën 744,179,107 lekë, ku peshën kryesore e zë zëri 2.1 paga (bazë) me totalin prej 500,125,867 lekë. UPT pasohet nga UAMD, me vlerën 533,194,298 lekë.

Brenda kategorisë së pagave, shpesh nga të gjashtë universitetet shohim konfuzion në përdorimin e zërave të thesarit, vihen re paga bazë që kalojnë si honorarë, kontrata me kohë të kufizuar që kalojnë për pagë bazë etj. Këto konfuzione dhe mungesë transparence në zëra shfaqen kryesisht brenda kategorisë kryesore.

Ndërkohë për të pestin vit radhazi Universiteti “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan, vijon ta kalojë fondin e pagave tek personi Filip Qosja, që mban edhe postin e financierit të universitetit dhe jo në llogaritë e vetë pedagogëve.

Kategori /Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
<b>Shpenzime personeli total</b>	<b>305,949,141</b>	<b>80,816,120</b>	<b>383,693,367</b>	<b>243,791,434</b>	<b>533,194,298</b>	<b>744,179,107</b>
<b>Paga</b>	297,500,205	54,903,511	361,886,019	229,321,690	492,828,844	500,125,867
<b>Honorare + Të tjera shpërblime për personelin</b>	5,686,703	21,881,556	3,373,918	1,910,948	996,043	44,258,977
<b>Paga me kontratë për kohë të kufizuar</b>	0	0	0	9,035,984	31,907,842	170,635,601
<b>Dieta Udhëtime</b>	2,762,233	4,031,053	13,570,248	1,950,312	1,698,569	14,521,370
<b>Pagesa anëtarët e Bordit Administrativ( + Senati)</b>	0	0	4,863,182	1,572,500	5,763,000	14,637,292

## b. Kategoria “Investime”

Në kategorinë Investime Universiteti i Tiranës ka kryer shpenzimet më të larta me total vlerën 344,988,799 lekë ku peshën kryesore e zë blerja e mjeteve dhe pajisjeve teknike me vlerë 136,847,464 lekë, pasuar nga UPT me total vlerën e Investimeve prej 51,448,811 lekë nga të cilat 47,869,412 lekë në zërin rikonstruksion ndërtesash. Pas denoncimeve të shumta nga Qëndresa Qytetare lidhur me mjetet e transportit asnjëri nga universitetet nuk ka shpenzuar në mjete transporti ndërsa vetëm Universiteti i Tiranës dhe Universiteti “Fan Noli” Korçë nuk kanë shpenzuar në zërin Studime dhe Kërkime.

### UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

- Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor  
Emri: Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës  
Adresa: Lagjia Nr. 1, Rruga “Taulantia”, Currila, Durrës  
Tel/Fax: 0676012050  
E-mail: daortaberaj@gmail.com  
Web-faqe: www.uamd.edu.al
- Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur
- Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-13107-11-25-2021.
- Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Ndërtimi i Murit Rrethues, Hyrjes Kryesore, Parkimit si dhe Krijimi i Hapësirave Rekreative në Kampusin Universitar të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës”.
- Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Punime ndërtimi 45210000-2
- Fondi limit: 113.946.595 (njëqind e trembëdhjetëmilion e nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
- Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 4 muaj duke filluar nga momenti i pajisjes me leje nga autoritetet perkatese.
- Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Datë 16/12/2021 Ora 11: 00 në adresën www.app.gov.al.

4 nga 6 universitete nuk kanë bërë shpenzime për pajisje pastrimi, ndërsa UT ka kryer një shpënzim të konsiderueshëm në vlerën 9 484 848 lekë për pajisje pastrimi.

Investimin më të madh e ka realizuar Universiteti i Tiranës ku ka shpenzuar rreth 2 milion euro për ndërtimin e katiit të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe rreth 220 000 euro për mirëmbajtje të ambienteve rrethuese të universitetit. Ndërsa UAMD ka shpenzuar rreth **1 milion euro për ndërtimin e murit rrethues të kampusit** dhe

parkingut përpara universitetit, ndërsa 260 000 euro vetëm për projektimin e rindërtimit të godinave të FSP dhe UAMD, një kosto mjaft e lartë kjo në raport me vetë investimin.

Kategori/Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
<b>III Investime</b>	<b>9,470,023</b>	<b>344,988,799</b>	<b>26,381,369</b>	<b>40,998,231</b>	<b>15,773,185</b>	<b>51,448,811</b>
3.1 Rikonstruksion i ndërtesave shkollore	919,725	36,343,756	21,483,725	22,865,313	12,991,885	47,869,412
3.2 Pajisje pastrimi	0	9,484,848	597,480	0	0	0
3.3 Mjete transporti (dhe Shërbime të tyre)	0	0	0	0	0	0
3.4 Mjete dhe pajisje teknike	7,039,560	162,847,464	336,926	909,480	869,182	2,671,871
3.5 Pajisje zyre dhe orendi të tjera	969,148	136,312,731	3,823,008	17,223,438	1,476,000	116,400
3.6 Studime dhe kërkime	541,590	0	140,230	0	436,118	791,128

### UNIVERSITETI I TIRANËS

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:  
Emri UNIVERSITETI I TIRANËS  
Adresa Blv. "Dëshmorët e kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë  
Tel/Fax Tel. +35542258446  
E-mail s\_dafa@unitir.edu.al  
Ueb Faqe www.unitir.edu.al
2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetary
3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-07828-10-12-2021
4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Blerje pajisje mobilimi dhe grila për UT
5. Fondi limit: 36,491,860 (tridhjetë e gjashtëmilion katërqind e nëntëdhjetë e njëmijë tetëqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSh
6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 60 ditë
7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 29/10/2021 ; Ora: 11:00

### UNIVERSITETI "A.XHUVANI" ELBASAN

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:  
Emri Universiteti "A.Xhuvani" Elbasan  
Adresa Rruga "Ismail Zyma" Elbasan  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail njesi-prokurimi@uniel.edu.al  
Faqja e Internetit www.uni-el.edu.al
2. Lloji i procedurës së prokurimit: "Procedurë e Hapur"
3. Numri i referencës së procedurës: REF-09873-10-29-2021
4. Objekti i kontratës : "Dixhitalizim i burimeve bibliotekare ne Universitetin e Elbasanit "Aleksander Xhuvani".
5. Fondi limit: 39.910.297 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.
6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 16.11.2021, Ora: 11:00

Universiteti i Tiranës ka shpenzuar vlera të larta për zërin e orendive. UT ka shpenzuar 350 000 euro për blerjen e mobiljeve dhe grilave për universitetin, pavarësisht investimeve në rikonstrukcione të njëpasnjëshme të vetë godinave të fakulteteve gjatë viteve të fundit. Edhe Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan ka realizuar një shpenzim prej 58 000 eurosh për mobilje për zyrat dhe auditoret.

Në nëntor të vitit 2021 Universiteti "Aleksandër Xhuvani" ka realizuar një shpenzim të lartë me titull "Digjitalizimi i burimeve bibliotekore" me vlerë 400 000 euro, si edhe mirëmbajtje të databazës me vlerë 100 000 euro. Kjo është një vlerë mjaft e lartë dhe do duhet të shërbente për digjitalizimin e gjithë procesit mësimor, përfshirë kurrikulat dhe literaturën, ndërkohë që studentët vijojnë të bëjnë mësim me libra të blerë në librari. Nëse kësaj vlere i

shtojmë edhe bibliotekën digjitale e cila është blerë rreth 600 000 euro nga Ministria e Arsimit, sërish studentët vijojnë të shpenzojnë para për blerjen e librave dhe fotokopjet e leksioneve, pra këto shpenzime nuk kanë zgjidhur thelbin e këtij shërbimi të ofruar ndaj studentit. Ndërkohë Universiteti i Tiranës ka shpenzuar rreth 150 000 euro për blerjen e një Laboratori Përkthimi dhe Interpretimi në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

## c. Kategoria “Blerje mallrash”

Katër (4) nga gjashtë (6) universitetet publike janë treguar të rezervuara gjatë këtij viti akademik në blerjen e karburantit për makinat. Shifrën më të lartë e ka shpenzuar Universiteti i Shkodrës, “Luigj Gurakuqi” me 75 000 euro.

### UNIVERSITETI I TIRANËS

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:  
Emri UNIVERSITETI I TIRANËS  
Adresa Blv. “Dëshmorët e kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë  
Tel/Fax Tel. +35542258446  
E-mail s\_dafa@unitir.edu.al  
Ueb Faqe [www.unitir.edu.al](http://www.unitir.edu.al)
2. Lloji i procedurës së prokurimit: Proçedurë e Hapur, e thjeshtuar
3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-16757-12-30-2021
4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje letër dhe materiale kancelarie për UT-në”.
5. Fondi limit: 8,476,581.00 (tetëmilion katërqind e shtatëdhjetë e gjashtëmijë pesëqind e tetëdhjetë e një)Lekë pa TVSh.
6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 60 ditë.

Një shpenzim i cili bie në sy më tepër tek Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës është ai i letrave A4 dhe bojrave të printerave. Ndërkohë që studentët nuk kanë akses në këto universitete për të printuar për punët e tyre. **UT me paratë e studentëve ka blerë 84 000 euro letra A4 dhe rreth 100 000 euro bojra printeri**, ndërsa UPT ka shpenzuar 61 000 euro për bojra printeri dhe 44 000 euro për letër A4. Edhe gjatë vitit 2020 – 2021 UT ka blerë në të

njëjtën vlerë letra A4, fakt që tregon se këto letra përdoren apo konsumohen brenda 1 viti akademik dhe jo në afatgjatë.

Buletini Nr.185 datë 20 Dhjetor 2021

Agjencia e Prokurimit Publik

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:  
Emri **UNIVERSITETI I TIRANËS**  
Adresa Blv. “Dëshmorët e kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë  
Tel/Fax Tel. +35542258446  
E-mail s\_dafa@unitir.edu.al  
Ueb Faqe [www.unitir.edu.al](http://www.unitir.edu.al)
2. Lloji i procedurës së prokurimit: Proçedurë e Hapur, e thjeshtuar
3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-14846-12-13-2021
4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik (diploma)
5. Fondi limit: 6,943,040.00 (gjashtëmilion nëntëqind e dyzet e tremijë e dyzet) Lekë pa TVSh.
6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 18 muaj
7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 24/12/2021; Ora 11:00

Por pavarësisht blerjes së letrave, printerave dhe bojrave këto universitete nuk arrijnë dot që të printojnë brenda tyre as kartonat e diplomave që lëshojnë vetë, e për këtë arsye zhvillojnë tendera me të tretë për realizmin e tyre. Universiteti që ka shpenzuar më shumë për kartonat e diplomave është Universiteti i Tiranës me një vlerë prej 70 000 eurosh vetëm për printimin e diplomave.

Krahasur me 5 vite më parë kur nisi monitorimi i Qëndresës Qytetare për shpenzimet e universiteteve publike, universitetet kanë qënë më të prirura për të orientuar fonde për blerjen e librave, megjithëse këto në shumica jo të larta. Universiteti i Tiranës ka shpenzuar 110 000 euro për blerjen e librave, po kaq edhe ai “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Të gjashtë universitetet e marra në monitorim e kanë përdorur fondin për libra, pavarësisht shumave të ndryshme nga njëri tek tjetri.

	Kategori/Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
<b>IV</b>	<b>Blerje mallrash</b>	<b>46,103,504</b>	<b>45,631,016</b>	<b>49,485,460</b>	<b>20,277,847</b>	<b>43,426,189</b>	<b>48,143,324</b>
4.1	Energji elektrike	8,036,213	1,506,178	8,133,528	4,566,382	19,578,547	24,677,840
4.2	Karburant dhe vaj	7,499,877	1,439,926	3,398,698	577,500	420,280	0
4.3	Ujë	1,066,169	101,952	2,869,260	1,230,405	2,145,344	3,247,445
4.4	Ngrohje + Pastrim	0	9,112,551	40,350	3,241,714	2,629,342	449,400
4.5	Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	1,686,140	17,010,470	4,236,565	2,218,924	1,750,059	9,748,360
4.6	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	605,417	4,380,886	2,107,037	401,039	0	451,800
4.7	Libra dhe publikime profesionale	1,056,577	7,462,990	1,981,443	1,916,923	2,904,789	2,087,626
4.8	Materiale dhe shërbime operative	494,240	3,548,100	1,618,179	1,439,883	4,541,828	1,446,053
4.9	Pajisje Informatike	25,615,053	1,067,963	25,100,400	4,685,077	9,456,000	0
4.1 0	Materiale të tjera	43,818	0	0	0	0	6,034,800

### UNIVERSITETI ALEKSANDER XHUVANI ELBASAN

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontrakt

Emri           Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"  
 Adresa        Rruga "Ismail Zyma" Elbasan  
 Tel/Fax  
 E-mail        [njesi-prokurimi@uniel.edu.al](mailto:njesi-prokurimi@uniel.edu.al)  
 Faqja e Internetit [www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al)

2. Lloji i procedurës: "Procedurë e Hapur"

3. Objekti i kontratës: "Blerje pajisje kompjuterike e fotokopje"

4. Fondi limit: : 21,130,506 (njëzetë e një million e njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e gjashtë) lekë pa tvsh..

5. Numri i Referencës së procedurës: REF-02254-08-04-2021

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës:

Vlera me TVSH: 25,100,400 (njëzetë e pesë milion e njëqind mijë e katërqind)

7. Data e lidhjes së kontratës: 27.09.2021

Universitet "Aleksandër Moisiu" Durrës ka shpenzuar 39 000 euro për printime, ndërkohë që ky universitet zotëron printera dhe ky shërbim mund të merrej prej tyre pa një kosto kaq të lartë, ndërsa Universiteti "Aleksandër Xhuvani" ka shpenzuar 210 000 euro për blerjen e kompjuterave për universitetin.

## d. Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”

Sigurimi i godinave të universiteteve me roje private vijon të zërë peshën kryesore të shpenzimeve të disa prej universiteteve publike. Pavarësisht kritikave që Kryeminsitri Rama u drejtoi Rektorëve për këtë zë dhe protesta studentore e vitit 2018, drejtuesit e universiteteve nuk janë treguar racionalë

në këtë drejtim. **Gjashtë universitet publike të monitoruara kanë shpenzuar rreth 2.1 milion euro për sigurinë e godinave të universiteteve**, shumë e cila mund të tejkalojë edhe vlerën që kanë pajisjet që ndodhen brenda tyre.

**Universiteti i Tiranës ka shpenzimin më të lartë për këtë zë me 637 454 euro** vetëm për rojet tek dyert e godianve. Sikur të mos mjaftonin këto para për rojet, ky universitet ka shpenzuar edhe 58 000 euro për sigurimin e ndërtesës në një kompani siguracioni.

Universiteti Politeknik i Tiranës ka kryer transaksione me vlerën e 50 000 eurove për aktivitete sociale për personelin dhe pjesëmarrje në evente dhe konferenca. Universiteti i Tiranës gjithashtu ka shpenzuar vlerën më të lartë për Instalim dhe Mirëmbajtje Rrjetesh Informatike në total prej 472 346 euro, ndërsa UAMD është universiteti i vetëm që nuk ka kryer asnjë shpenzime në këtë zë.

### UNIVERSITETI I TIRANËS

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor  
 Emri UNIVERSITETI I TIRANËS  
 Adresa Blv. “Dëshmorët e kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë  
 Tel/Fax Tel. +35542258446  
 E-mail s\_dafa@unitir.edu.al  
 Faqja në Internet www.unitir.edu.al

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këmbëllë i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.univ.edu.al> 244/343

Buletini Nr. 187 datë 28 Dhjetor 2021

Agjencia e Prokurimit Publik

- Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur, e thjeshtuar.
- Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuaðër: “Shpenzime për sigurime ndërtesash, pajisjesh, etj për UT”.
- Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-12577-11-23-2021
- Fondi limit: 5,837,000 (pesëmilion e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë) Lekë pa TVSh.
- Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nënkontraktimin): 5,811,740 (pesëmilion tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë me TVSh.
- Data e lidhjes së kontratës: 17.12.2021.
- Emri dhe adresa e kontraktorit/nënkontraktorit: “ALBSIG” sha, me adresë: Rruga e Barrakadave, Pallatet 9-Katëshe, Nr.1001, Tiranë, me NIPT K42108801C.

	Kategori/Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
<b>V</b>	<b>Sigurimi i shërbimeve</b>	<b>50,028,596</b>	<b>169,916,554</b>	<b>76,579,050</b>	<b>26,921,256</b>	<b>32,427,968</b>	<b>67,547,415</b>
<b>5.1</b>	Posta dhe shërbimi korrier	49,445	134,236	64,500	43,345	48,150	147,940
<b>5.2</b>	Telefon dhe internet	418,470	855,410	2,747,086	165,269	527,374	2,475,366
<b>5.3</b>	Pastrim dhe gjelbërim	429,589	117,600	3,733,332	87,600	3,282,484	1,276,150
<b>5.4</b>	Shërbime të tjera transporti	269,715	519,820	696,177	897,912	14,968	525,872
<b>5.5</b>	Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	29,544,109	74,582,133	50,537,505	23,385,140	22,821,665	38,053,713
<b>5.6</b>	Shërbime të tjera	1,007,536	6,617,600	2,941,600	0	254,400	15,378,721
<b>5.7</b>	Aktivitete sociale për personelin	396,400	949,370	415,665	911,775	1,125,876	5,838,788
<b>5.8</b>	Mirëmbajtje ndërtesash	16,995,852	26,865,419	0	314,215	117,149	1,059,600
<b>5.9</b>	Instalim dhe mirëmbajtje rrjetesh informatike	5,000	55,264,590	13,418,965	504,000	0	2,208,185
<b>5.10</b>	Mirëmbajtje të tjera	912,480	4,010,376	2,024,220	612,000	4,235,902	583,080



## e. Kategoria “Bursa dhe transferta për subvencione të tjera”

Kategoria **Transferta dhe Subvencione** tregon edhe njëherë mungesën e projekteve ku janë të përfshira universitetet e monitoruara, ku përveç Universitetit të Tiranës që ka realizuar një pagesë për zërin e projekteve në masën 233 416 euro, universitetet e tjera kanë shpenzuar pak ose aspak për projekte, të cilat kryesisht janë shkencore dhe përfshijnë stafin akademik dhe studentët.

Të gjashtë Universitet kanë bërë transaksione të konsiderueshme nën zërin Komisione Bankare/të tjera tek individët ku një pjesë e mirë e tyre janë rikthim shumash të kaluara gabim nga studentët në llogari të universiteteve.

Përsa i përket mbështetjes financiare me bursa studimi dhe mbështetje të nxënësve të dalluar, Universiteti i Elbasanit vazhdon të jetë universiteti me vlerën më të lartë të transaksioneve të kryera, pasuar nga UPT.


Duhet të theksojmë se paratë të cilat shkojnë për bursat e studentëve vijnë nga të ardhurat e buxhetit të shtetit në formën e grantit drejtuar universiteteve dhe jo nga paratë e siguruar nga tarifat e studentëve.

Kategori/Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
<b>VI Transferta dhe Subvencione</b>	<b>2,070,321</b>	<b>34,075,358</b>	<b>3,246,331</b>	<b>2,468,252</b>	<b>11,377,381</b>	<b>13,656,192</b>
6.1 Transferta për projekte	0	27,309,708	100,000	85,000	4,765,440	42,721
6.2 Kuota Anëtarësimi	420,200	1,428,008	846,897	172,120	1,012,228	9,533,847
6.3 Komisione Bankare	1,650,121	5,337,642	2,299,434	2,211,132	5,599,713	4,079,624
<b>VII Të tjera</b>	<b>50,794,300</b>	<b>418,346</b>	<b>105,918,010</b>	<b>44,212,134</b>	<b>62,154,500</b>	<b>101,136,830</b>
7.1 Mbështetje e studentëve dhe bursa studimi	50,710,000	0	105,888,010	44,100,000	62,134,500	100,844,094
7.2 Shpenzime gjyqësore	84,300	418,346	30,000	112,134	20,000	292,736

## f. Pasqyrë e plotë e shpenzimeve të 6 universiteteve publike në periudhën 1 Shtator 2021 – 31 Gusht 2022

	Kategori/Nënkategori	U.Shkodres	U.Tiranes	U. Elbasanit	U. Korces	U.Durresit	U.P.Tiranes
<b>II</b>	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>305,949,141</b>	<b>80,816,120</b>	<b>383,693,367</b>	<b>243,791,434</b>	<b>533,194,298</b>	<b>744,179,107</b>
2.1	Paga	297,500,205	54,903,511	361,886,019	229,321,690	492,828,844	500,125,867
2.2	Honorare + Te tjera shperblime per personelin	5,686,703	21,881,556	3,373,918	1,910,948	996,043	44,258,977
2.3	Paga me kontrate per kohe te kufizuar	0	0	0	9,035,984	31,907,842	170,635,601
2.4	Dieta Udhetime	2,762,233	4,031,053	13,570,248	1,950,312	1,698,569	14,521,370
2.5	Pagesa anetaret e bordit administrativ( + Senati)	0	0	4,863,182	1,572,500	5,763,000	14,637,292
<b>III</b>	<b>Investime</b>	<b>9,470,023</b>	<b>344,988,799</b>	<b>26,381,369</b>	<b>40,998,231</b>	<b>15,773,185</b>	<b>51,448,811</b>
3.1	Rikonstruksion i ndërtesave shkollore	919,725	36,343,756	21,483,725	22,865,313	12,991,885	47,869,412
3.2	Pajisje pastrimi	0	9,484,848	597,480	0	0	0
3.3	Mjete transporti	0	0	0	0	0	0
3.4	Mjete dhe pajisje teknike	7,039,560	162,847,464	336,926	909,480	869,182	2,671,871
3.5	Pajisje zyre dhe orendi të tjera	969,148	136,312,731	3,823,008	17,223,438	1,476,000	116,400
3.6	Studime dhe kërkime	541,590	0	140,230	0	436,118	791,128
<b>IV</b>	<b>Blerje mallrash</b>	<b>46,103,504</b>	<b>45,631,016</b>	<b>49,485,460</b>	<b>20,277,847</b>	<b>43,426,189</b>	<b>48,143,324</b>
4.1	Energji elektrike	8,036,213	1,506,178	8,133,528	4,566,382	19,578,547	24,677,840
4.2	Karburant dhe vaj	7,499,877	1,439,926	3,398,698	577,500	420,280	0
4.3	Ujë	1,066,169	101,952	2,869,260	1,230,405	2,145,344	3,247,445
4.4	Ngrohje + Pastrim	0	9,112,551	40,350	3,241,714	2,629,342	449,400
4.5	Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	1,686,140	17,010,470	4,236,565	2,218,924	1,750,059	9,748,360
4.6	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	605,417	4,380,886	2,107,037	401,039	0	451,800
4.7	Libra dhe publikime profesionale	1,056,577	7,462,990	1,981,443	1,916,923	2,904,789	2,087,626
4.8	Materiale dhe shërbime operative	494,240	3,548,100	1,618,179	1,439,883	4,541,828	1,446,053
4.9	Pajisje Informatike	25,615,053	1,067,963	25,100,400	4,685,077	9,456,000	0
4.10	Materiale të tjera	43,818	0	0	0	0	6,034,800
<b>V</b>	<b>Sigurimi i shërbimeve</b>	<b>50,028,596</b>	<b>169,916,554</b>	<b>76,579,050</b>	<b>26,921,256</b>	<b>32,427,968</b>	<b>67,547,415</b>
5.1	Posta dhe shërbimi korrier	49,445	134,236	64,500	43,345	48,150	147,940
5.2	Telefon dhe internet	418,470	855,410	2,747,086	165,269	527,374	2,475,366
5.3	Pastrim dhe gjelbërim	429,589	117,600	3,733,332	87,600	3,282,484	1,276,150
5.4	Shërbime të tjera transporti	269,715	519,820	696,177	897,912	14,968	525,872
5.5	Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	29,544,109	74,582,133	50,537,505	23,385,140	22,821,665	38,053,713
5.6	Shërbime të tjera	1,007,536	6,617,600	2,941,600	0	254,400	15,378,721
5.7	Aktivitetet sociale per personelin (dhe pjesmarrje ne evente e konferenca)	396,400	949,370	415,665	911,775	1,125,876	5,838,788
5.8	Mirëmbajtje ndërtesash	16,995,852	26,865,419	0	314,215	117,149	1,059,600
5.9	Instalim dhe mirëmbajtje rrejtsh informatike	5,000	55,264,590	13,418,965	504,000	0	2,208,185
5.10	Mirëmbajtje të tjera	912,480	4,010,376	2,024,220	612,000	4,235,902	583,080
<b>VI</b>	<b>Tranferata dhe Subvencione</b>	<b>2,070,321</b>	<b>34,075,358</b>	<b>3,246,331</b>	<b>2,468,252</b>	<b>11,377,381</b>	<b>13,656,192</b>
6.1	Tranferata për projekte	0	27,309,708	100,000	85,000	4,765,440	42,721
6.2	Kuota Antaresimi	420,200	1,428,008	846,897	172,120	1,012,228	9,533,847
6.3	Komisione Bankare/ te tjera tek individe	1,650,121	5,337,642	2,299,434	2,211,132	5,599,713	4,079,624
<b>VII</b>	<b>Të tjera</b>	<b>50,794,300</b>	<b>418,346</b>	<b>105,918,010</b>	<b>44,212,134</b>	<b>62,154,500</b>	<b>101,136,830</b>
7.1	Mbështetje e nxënësve të dalluar dhe bursa studimi	50,710,000	0	105,888,010	44,100,000	62,134,500	100,844,094
7.2	Shpenzime gjygesore	84,300	418,346	30,000	112,134	20,000	292,736
	<b>Totali</b>	<b>464,415,885</b>	<b>675,846,193</b>	<b>645,303,587</b>	<b>378,669,154</b>	<b>698,353,521</b>	<b>1,026,111,679</b>

## 6. PORTALI U-TRANSPARENCA.AL



Në përgjigje të një ndër kërkesave kryesore të protestës së studentëve në dhjetor 2018, qeveria nxori VKM nr. 781 për garantimin e transparencës së institucioneve të arsimit të lartë, pavarësisht ekzistencës së ligjit për të drejtën e informimit dhe detyrimeve që ai parashikon për çdo autoritet publik.

Nga verifikimet e kryera nga ekipi i Qëndresës Qytetare ky portal nuk përmban të dhëna mbi shpenzimet në nivel universiteti apo rektorati, por vetëm të dhëna në nivel fakulteti, gjë që u

vështirëson studentëve të kuptojnë shpenzimet totale të universitetit dhe raportin e shpenzimeve për mënyrën se si harxhohen paratë e tyre.

Një tjetër mangësi e këtij portali janë prokurimet publike, ku për vitin 2021 - 2022 nuk kemi të publikuar asnjë kontratë të lidhur nga asnjë universitet, ndërkohë që nga monitorimi ynë rezultojnë dhjetëra kontrata të lidhura nga universitetet me operatorë privatë të tretë nëpërmjet procedurave të tenderimit.

Ndërsa sa i përket vendimeve të organeve administrative dhe akademike, janë publikuar vetëm ato vendime që kanë lidhje me bursat dhe tarifat, por jo vendime me efekt financiar dhe legjislativ brenda universitetit.

Njëkohësisht ky portal duhet të përmbante të gjitha CV-të e pedagogëve të universiteteve sipas VKM, brenda muajit Shkurt, por ende shohim që ka shumë mangësi në këtë drejtim dhe pothuajse i gjithë materiali është i paplotë.

Në pikën “gj” të këtij vendimi parashikohet se brenda portalit u-transparenca.al do të gjenden edhe rezultatet e verifikimit të titujve akademikë, por jo vetëm që kjo kategori nuk është parashikuar dhe nuk ekziston në portal, por procesi nuk është më në duart e Minsitrisë dhe ju ka kaluar vetë universiteteve të cilat e kanë kthyer verifikimin në vetëdeklarim.

Një nga 9 kërkesat e protestës së pedagogëve ishte edhe rishikimi i këtij protali nga Ministria e Arsimit dhe universitetet për të bërë transparencë të plotë të shpenzimeve.


## 7. UNIVERSITETET DHE E DREJTA E INFORMIMIT

Në datën 23 shtator 2022 Qëndresa Qytetare i dërgoi kërkesa për informacion 6 universiteteve publike të marra në monitorim lidhur me kopjet e kontratave dhe anekseve të tyre shoqëruese, për të kuptuar më shumë se si zbërthehen zërat e shpenzuar sipas kategorive të thesarit të shtetit. Pas pritjes prej 0 ditësh zyrtare pas dërgimit të kërkesave, asnjë prej universiteteve nuk kthehu përgjigje brenda afateve ligjore të ligjit për të drejtën e informimit.

Qëndresa Qytetare ankimoi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimiti 6 kërkesat pas procesit ankimues, Universiteti i Korçës ishte i pari që dërgoi informacionin, por kontratat që ky universitet përcolli ishin pa detajet e tyre të produkteve apo shërbimeve që ishin blerë, ndërsa i dyti ishte Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, universitet i cili ka dërguar pjesën dërmuese të kontratave së bashku me anekset shoqëruese, pas ankimimit të organizatës pranë KDIMP.

2 universitetet e tjera, Universiteti i Shkdores dhe ai i UPT pas ankimimit te dyfishte dhe ndërhyrjes së zyrës së Komisionerit derguan informacionin e kërkuar. Universiteti i Tiranës dhe Universiteti "Aleksander Moisiu" i Durrësit, në sinkron mes tyre u përgjigjën se informacioni i kërkuar cënon sekretin tregëtar dhe dhënia e këtij informacioni është i ndalaur sipas nenit 17 pika 1 të ligjit për të drejtën e infromimit.

Por rasti konkret përbën një interes të lartë publik dhe nuk shkakton asnjë prej dëmëve të parashikuara në nenin 17 pika si psh nxjerrjen



e sekretit shtetëror, dhe si i fillë ky informacion duhet të kthehej. Nisur edhe nga analogjia dhe praktika e mëparshme, këto universitete gjatë vitit akademik 2020 – 2021 i kanë vënë në dispozicion të Qëndresës Qytetare kontratat e tyre edhe përgjatë vitit akademik 2021 – 2022 pa ndryshuar asnjë normë ligjore, refuzuan të përgjigjen.



## 8. REKOMANDIME
















- Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të nisë menjëherë auditim për rregullshmërinë financiare të universiteteve publike në vend duke marrë në shqyrtim buxhetet, bilancet, kontratat dhe gjendjen e magazinuar të mallrave të blera nga paratë e tarifave të studentëve.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të zbatojë plotësisht VKM 781, dt. 26.12.2018 duke përditësuar dhe plotësuar me kategoritë që mungojnë portalin u-transparenca.al përfshi, vendimet e zbardhura të Bordeve të Administrimit, kontratat me të tretët dhe prokurimet për vitin 2021 - 2022.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit të inspektojë buxhetet, transaksionet dhe ofrimin e shërbimeve të universiteteve publike sipas parashikimeve të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor e të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore në raste shkeljesh.
- Universitetet publike duhet të përditësojnë dhe personalizojnë programet e transparencës në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit dhe të aplikojnë vendimmarrje financiare të hapur, me përfshirjen e studentëve e në konsultim të vazhdueshëm me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Universitetet publike duhet të alokojnë më shumë para për zërat e kërkimit shkencor dhe pasurimit të bibliotekave të tyre me librat që përmban kurikula mësimore dhe më pak para për siguri, kamera dhe siguracione godinash.
- Këshillat Studentore dhe përfaqësuesit e studentëve në Bordet e Administrimit duhet të bëhen pjesë e vendimmarrjes duke verifikuar çdo blerje, çdo kontratë lidhur me të tretët dhe çdo shërbim të ofruar nga universiteti ku studiojnë dhe të informojnë studentët mbi këto fakte.
- Këshillat Studentore dhe studentët të kërkojnë nga anëtarët e Bordit të Administrimit të propozuar prej tyre llogari periodike për çdo veprim financiar që ka ndërmarrë universiteti.

## 9. SKEDAT E TRANSPARENCES



**Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan**  
Skeda e Transparencës

**VITI AKADEMIK 2021- 2022**

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:	2021-22	2020-21	2019-2020
 <b>Siguri godine</b>	 <b>431 944 €</b>	418 517 €	401 905 €
 <b>Telefon/ internet stafi</b>	 <b>23 479 €</b>	5 922 €	8 673 €
 <b>Studime dhe kërkime</b>	<b>1 200 €</b>	710 €	3 828 €
 <b>Libra dhe publikime</b>	<b>17 000 €</b>	15 050 €	12 061 €
 <b>Karburant makine</b>	 <b>29 000 €</b>	17 300 €	42 191 €
 <b>Pajisje zyre dhe orendi</b>	<b>32 675 €</b>	128 300 €	0 €
 <b>Shpërblime dhe honorare</b>	<b>28 836 €</b>	827 577 €	3900 €
 <b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>256 €</b>	14 600 €	67 700 €
 <b>Dieta/ Udhëtime</b>	 <b>115 985 €</b>	5 000 €	27 700 €
 <b>Ngrohje dhe pastrim</b>	<b>300 €</b>	5 000 €	
 <b>Shpenzime personeli</b>	<b>3 279 430 €</b>	3 036 5930 €	3 365 577 €

**Shpenzime totale në 1 Vit: 5 515 415 €uro**














\* Totali nuk është shumësi e zërave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të përzgjedhura për tu krahesuar



## Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër

### Skeda e Transparencës

VITI AKADEMIK 2021- 2022

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:	2021-22	2020-21	2019-2020
 <b>Siguri godine</b> 	<b>252 513 €</b>	230 000 €	238 160 €
 <b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>3 576 €</b>	2 300 €	2 941 €
 <b>Studime dhe kërkime</b>	<b>4 628 €</b>	0 €	0 €
 <b>Libra dhe publikime</b>	<b>9 030 €</b>	800 €	0 €
 <b>Karburant makine</b> 	<b>64 100 €</b>	0 €	14 680 €
 <b>Pajsisje zyre dhe orendi</b>	<b>8 283 €</b>	0 €	389 000 €
 <b>Shpërblime dhe honorare</b>	<b>48 600 €</b>	42 600 €	0 €
 <b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>7 00 €</b>	0 €	0 €
 <b>Dieta/ Udhëtime</b>	<b>23 600 €</b>	6 650 €	53 114 €
 <b>Ngrohje dhe pastrim</b>	<b>0 €</b>	51 500 €	
 <b>Shpenzime personeli</b>	<b>2 614 949 €</b>	2 573 900 €	2 375 000 €

**Shpenzime totale në 1 Vit: 3 969 366 €uro**

\* Totali nuk është shumësi e zërave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të përzgjedhura për tu krahesuar





## Universiteti "Fan Noli" Korçë

Skeda e Transparencës

VITI AKADEMIK 2021- 2022

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

	2021-22	2020-21	2019-2020
 <b>Siguri godine</b>	<b>199 872 €</b>	171 930 €	158 180 €
 <b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>1 500 €</b>	1 500 €	1 851 €
 <b>Studime dhe kërkime</b> 	<b>0 €</b>	0 €	777 €
 <b>Libra dhe publikime</b>	<b>16 383 €</b>	28 400 €	560 €
 <b>Karburant makine</b>	<b>4 935 €</b>	4200 €	0 €
 <b>Pajisje zyre dhe orendi</b> 	<b>147 085 €</b>	7 125 €	0 €
 <b>Shpërblime dhe honorare</b>	<b>16 332 €</b>	64 260 €	5 450 €
 <b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>980 €</b>	200 €	3 178 €
 <b>Dieta/ Udhëtime</b> 	<b>77 230 €</b>	20 650 €	17 113 €
 <b>Ngrohje dhe pastrim</b>	<b>27 706 €</b>	37 200 €	0 €
 <b>Shpenzime personeli</b>	<b>2 083 687 €</b>	2 181 400 €	1 785 000 €

**Shpenzime totale në 1 Vit: 3 236 488 €uro**

\* Totali nuk është shumësi e zërave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të përzgjedhura për tu krahesuar



## Universiteti "Aleksandër Moisiu"

Skeda e Transparencës

VITI AKADEMIK 2021- 2022

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

	2021-22	2020-21	2019-2020
 <b>Siguri godine</b>	 <b>195 000 €</b>	191 500 €	137 726 €
 <b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>4 507 €</b>	1600 €	640 €
 <b>Studime dhe kërkime</b>	<b>3 727 €</b>	0 €	0 €
 <b>Libra dhe publikime</b>	<b>24 827 €</b>	200 €	759 €
 <b>Karburant makine</b>	<b>3 590 €</b>	49 500 €	102 555 €
 <b>Pajisje zyre dhe orendi</b>	<b>12 615 €</b>	187 000 €	194 113 €
 <b>Shpërblime dhe honorare</b>	<b>8 513 €</b>	1 750 000 €	11 351 €
 <b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>170 €</b>	6000 €	21 756 €
 <b>Dieta/ Udhëtime</b>	<b>14 500 €</b>	9760 €	6 600 €
 <b>Ngrohje dhe pastrim</b>	<b>22 473 €</b>	20 660 €	0 €
 <b>Shpenzime personeli</b>	<b>4 557 216 €</b>	4 018 116 €	4 057 106 €

**Shpenzime totale në 1 Vit: 5 968 833 €uro**

\* Totali nuk është shumësi e zërave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të përzgjedhura për tu krahasuar



# Universiteti i Tiranës


Skeda e Transparencës


VITI AKADEMIK 2021- 2022

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

	2021-22	2020-21	2019-2020
 <b>Siguri godine</b> 	<b>637 454 €</b>	555 250 €	527 000 €
 <b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>7 311 €</b>	7 755 €	37 400 €
 <b>Studime dhe kërkime</b>	<b>0 €</b>	0 €	0 €
 <b>Libra dhe publikime</b>	<b>63 786 €</b>	32 200 €	134 000 €
 <b>Karburant makine</b>	<b>12 300 €</b>	0 €	42 470 €
 <b>Pajisje zyre dhe orendi</b> 	<b>1 165 066 €</b>	224 000 €	413 800 €
 <b>Shpërblime dhe honorare</b>	<b>187 021 €</b>	192 000 €	1 725 800 €
 <b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>3 575 €</b>	3300 €	80 900 €
 <b>Dieta/ Udhëtime</b>	<b>34 453 €</b>	6650 €	53 114 €
 <b>Ngrohje dhe pastrim</b>	<b>77 885 €</b>	41 430 €	0 €
 <b>Shpenzime personeli</b> 			

**Shpenzime totale në 1 Vit: 5 776 463 €uro**

 Në totalin e shpenzimeve nuk janë përfshirë shpenzimet e pagave të fakulteteve të UT (përlllogaritura 9-10million Euro), të cilat kanë degë thesari të pavarura

 Totali nuk është shumësi e zërave me sipër; ato janë një pjesë e shpenzimeve të përzgjedhura për tu krahasuar



## Universiteti Politeknik i Tiranës Skeda e Transparencës

VITI AKADEMIK 2021- 2022

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:	2020-21	19-20	18-19
 <b>Siguri godine</b>	 <b>325 245 €</b>	321 378 €	300 000 €
 <b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>21 156 €</b>	28 000 €	35 000 €
 <b>Studime dhe kërkime</b>	<b>6 761 €</b>	17 000 €	3 400 €
 <b>Libra dhe publikime</b>	<b>17 842 €</b>	15 000 €	8 000 €
 <b>Karburant makine</b>	<b>0 €</b>	50 500 €	0 €
 <b>Pajisje zyre dhe orendi</b>	<b>994 €</b>	410 000 €	39 000 €
 <b>Shpërblime dhe honorare</b>	 <b>378 281 €</b>	64 260 €	636 600 €
 <b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>2 500 €</b>	4 700 €	7 420 €
 <b>Dieta/ Udhëtime</b>	 <b>124 114 €</b>	101 900 €	106 900 €
 <b>Ngrohje dhe pastrim</b>	<b>3 841 €</b>	177 000 €	0 €
 <b>Shpenzime personeli</b>	<b>6 360 500 €</b>	5 511 900 €	5 375 800 €

**Shpenzime totale në 1 Vit: 8 770 185 Euro**

\* Në totalin e shpenzimeve nuk janë përfshirë shpenzimet e pagave të fakulteteve të UT (përlogaritura 9-10 milion Euro), të cilat kanë degë thesari të pavarura

\* Totali nuk është shumësi e zërave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të përzgjedhura për tu krahesuar

## 6 UNIVERSITETE



Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

2021-22

Nga 2020-21

 <b>Siguri godine</b>	<b>2 042 087 €</b>	<b>+ 153 687 €</b>
 <b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>61 444 €</b>	<b>+ 14 300 €</b>
 <b>Studime dhe kërkime</b>	<b>16 316 €</b>	<b>- 1 383 €</b>
 <b>Libra dhe publikime</b>	<b>148 806 €</b>	<b>+ 57 356 €</b>
 <b>Karburant makine</b>	<b>113 959 €</b>	<b>- 7 540 €</b>
 <b>Pajsisje zyre dhe orendi</b>	<b>1 366 843 €</b>	<b>+ 410 418 €</b>
 <b>Shpërblime dhe honorare</b>	<b>667 590 €</b>	<b>- 2 565 846 €</b>
 <b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>8183 €</b>	<b>- 38 491 €</b>
 <b>Dieta/ Udhëtime</b>	<b>329 348 €</b>	<b>+ 182 088 €</b>
 <b>Ngrohje dhe pastrim</b>	<b>132 250 €</b>	<b>- 200 539 €</b>

**Shpenzime totale përgjatë  
1 viti ne 6 Universitete**

**33.2 MILION €URO**

\* Në totalin e shumave të shpenzimeve të 6 universiteteve nuk përfshihen shpenzimet e pagave të pedagogëve të Universitetit të Tiranës, të cilat oprijnë me degë thesari të ndryshme nga ajo e Rektoratit.

## 6 UNIVERSITETE

**2 042 087 €**

**RUAJTJE DHE  
SIGURI GODINE NË  
6 UNIVERSITETE**

**83 000 €**  
Sigurim pasurie

**16 316 €**

**STUDIME DHE  
KËRKIM SHKENCOR  
NË 6 UNIVERSITETE**



**SI SHPENZOHEN PARATE E UNIVERSITETEVE?**

Monitorimi Financiar i Universiteteve Publike në Shqipëri 2021– 2022



